

ARSIMI PROFESIONAL

KURRIKULA **Bërthamë**

Programi pilot për kualifikimin e profilit

Teknik dentar

Në lëminë "Shëndetësi"

Niveli 3 dhe 4 i Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës
Shkalla 5 e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës
Shkalla I e Arsimit Profesional

Klasat 10, 11, 12

**Hartuar me mbështetjen e Projektit KSV/015 "Mbështetje për
Reformën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë"**

Kosovë, 2013

I. Parathënie

II. Kurrikula bërthamë për profilin “Teknik dentar”, klasat 10-11-12

1. Njoftime të përgjithshme për profilin “Teknik dentar”, klasat 10-11-12.

- a. Struktura e shkollimit dhe certifikimi.
- b. Kërkesat e pranimit të nxënësve.
- c. Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit .
- d. Qëllimet e përgjithshme të shkollimit.
- e. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.
- f. Kompetencat profesionale të nxënësve.

2. Plani mësimor i profilit “Teknik dentar”, klasat 10-11.

3. Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.

4. Përshkruesit e moduleve profesionale

- a. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10-të
- b. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 11-të
- c. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 12-të

II. Kurrikula bërthamë për profilin “Teknik dentar”, klasat 10-11-12

1. Njoftime të përgjithshme për profilin “Teknik dentar”, klasat 10-11-12

a) Struktura e shkollimit dhe certifikimi.

Arsimimi në profilin mësimor “Teknik dentar” trajtohet në dy nivele:

- **niveli i parë** i arsimit profesional, me kohëzgjatje 2 vite mësimore (kl.10-të dhe 11-të) i përgatit nxënësit për nivelin fillestar (hyrës) të punësimit për profesionin e teknikut dentar. Në përfundim të këtij niveli nxënësit fitojnë certifikatën e nivelit të parë të arsimit profesional.
- **niveli i dytë**, i arsimit profesional, me kohëzgjatje një vit mësimor (klasa 12) pas përfundimit të nivelit të parë, i përgatit nxënësit për të fituar një kualifikim profesional që u mundëson atyre integrimin në tregun e punës si dhe vazhdimin e studimeve në nivele më të larta. Në përfundim të këtij niveli nxënësit fitojnë certifikatën e nivelit të dytë të arsimit profesional.

Ky dokument përmban kurrikulën bërthamë të profilit mësimor “Teknik dentar”, për nivelin e I të Arsimit Profesional, dhe është i strukturuar në:

- A. Lëndë të kulturës së përgjithshme (programet e tyre jepen në një dokument të veçantë të Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të cilat synojnë formimin e përgjithshëm të nxënësit.
- B. Module profesionale (të përbashkëta për lëminë mësimore përkatëse dhe të veçanta për profilin mësimor), përshkruesit e të cilëve jepen në këtë dokument. Këto module synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat profesionale të nevojshme për t’u integruar me sukses në tregun e punës.

b) Kërkesat e pranimit të nxënësve.

Shkollimin për “Teknik dentar”, niveli I, mund ta ndjekin të gjithë të rinjtë dhe të rejtat të cilët kanë përfunduar me sukses arsimin e detyruar nëntëvjeçar, janë në moshë deri 24 vjeç dhe zotërojnë aftësi shëndetësore (fizike e mendore) të mjaftueshme për të kryer këtë nivel shkollimi.

Në raste të veçanta, kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se sa kapacitetet reale të qendrës së kompetencës, MASHT përgatit udhëzime të veçanta me kriteret pranimit të posaçme për këto shkolla.

c) Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin mësimor “Teknik dentar”, niveli I (kl.10-11), i lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit në nivelin II (kl.12) të këtij profili mësimor.

Shkollimi për “Teknik dentar”, niveli I, i referohet veprimtarive profesionale që lidhen me punët me pajisjet, aparatet dentare, materiale si dhe punime bazë të protezave mobile pllakore (parciale, totale) si dhe protezave të skeletuara
Nisur nga kjo, tekniku dentar i nivelit I mund të punësohet si ndihmës në laboratorë tekniko-dentarë.

d) Qëllimet e përgjithshme të shkollimit.

Qëllimi kryesor i shkollimit për "Teknik dentar", niveli I dhe 2, është zhvillimi i personalitetit të nxënësve për t'u përfshirë në një shoqëri demokratike si qytetarë aktiv dhe kompetent, si dhe për t'u angazhuar me sukses në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi janë dhe zhvillimi i ndjenjës së vet-besimit të nxënësit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t'u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale. Për të realizuar këto qëllime, është e nevojshme që qendra e kompetencës t'u krijojë nxënësve:

- Mundësi të përshtatshme për të nxënë pavarësisht nga gjinia, raca, etniteti dhe aftësitë fizike e mendore;
- Mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet/vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e aftësisht profesional të mëtejshëm;
- Kushte për të njohur dhe zbatuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Kushte për t'u njohur me teknologjitë dhe proceset e punës aktuale e të perspektivës, në sektorin e laboratorëve dentarë;
- Lehtësi për të kuptuarit e mjedisit shoqëror dhe ekonomik, lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe për të qenë të vetëdijshëm për rolin që mund të luajnë në këtë mjedis.
- Mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe vlerat morale;
- Kushte për t'u zhvilluar psikikisht, emocionalisht dhe fizikisht, për të përballuar sfidat dhe vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale.
- Kushte për tu vlerësuar drejt dhe me realizëm në lidhje me potencialin dhe arritjet e tyre;
- Mbështetje për të marrë përgjegjësi në procesin e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional.
- Mbështetje për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë nëpërmjet përvojës së punës praktike.
- Mundësi për t'u njohur me zhvillimet perspektive të profesionit të tyre, të para këto në kontekstet e integritit rajonal dhe Evropian.

e) Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.

Ndjekja e shkollimit në profilin mësimor "Teknik dentar", niveli I dhe II, do të zhvillojë te nxënësit një tërësi kompetencash të përgjithshme të cilat do t'i shërbejnë atij në përvetësimin e me efektivitet të programit mësimor, si bazë për zhvillimin në nivelin e kërkuar të kompetencave profesionale, vijimin e shkollimit të mëtejshëm, si dhe integrimin e suksesshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të komunikojë dhe të përdorë burime të ndryshme informacioni në gjuhë të huaj.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë dhe ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të menaxhojë dhe përdorë me efektivitet burimet në dispozicion në funksion të përmbushjes së objektivave.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në marrjen e vendimeve për zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të manifestojë vetëbesim dhe qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive.
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe globale.
- Të tregojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vet-kontroll dhe pavarësi në vendim-marrje në ushtrimin e veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën.
- Të zbatojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të përbashkëta.
- Të vet-orientohet drejt për karrierën e punësimit dhe shkollimit të mëtejshëm.
- Të vlerësojë dhe vetë-vlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe cuar më tej të arriturat.

f) Kompetencat profesionale të nxënësve.

Ndjekja e shkollimit në profilin mësimor “**Teknik dentar**”, niveli I, do të zhvillojë te nxënësit edhe një tërësi kompetencash profesionale të cilat do t’i shërbejnë atij për vijimin e shkollimit dhe aftësimin profesional të mëtejshëm, si dhe për punësimin e suksesshëm në sektorin e kujdesitstomatologjik.

Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

(referuar kompetencave profesionale të përbashkëta -për lëminë):

- të dallojë ndërtimin anatomik të trupit të njeriut;
- të dallojë funksionet e organizmit sipas sistemeve të organeve;
- të zbatojë metodat e higjienës personale dhe të përgjithshme në lëminë e shëndetësisë;
- të zbatojë procedurat për parandalimin e infeksionit në lëminë e shëndetësisë;
- të zbatojë parimet e etikës shëndetësore në lëminë e shëndetësisë;
- të dallojë nevojat bazë të njeriut të shëndetshëm dhe të sëmurë;
- të sugjerojë dieta të thjeshta për njeriun e shëndetshëm dhe të sëmurë.
- të shpjegojë ndikimin e baktereve, myqeve dhe viruseve në organizmin e njeriut
- të shpjegojë masat për imunitetin e njeriut

(referuar kompetencave profesionale të profilit hartuar për klasën e 10-të dhe 11-të)

- të përdorë terminologji profesionale stomatologjike dhe nomenklaturën dentare
- të shpjegojë anatominë dhe fiziologjinë e sistemit orofacial
- të analizojë funksionet e sistemit orofacial
- të mirëmbajë mjedisin e punës në laboratorin dentar
- të bëjë vizatimin e lire të secilit dhëmb
- të dallojë artikulatorët dhe përdorimin e tyre
- të vizatojë dhe modelojë dhëmbët me gips

- të dallojë veçoritë e materialeve tekniko dentare
- të përgatisë proteza totale
- të përgatisë proteza parciale pllakore dhe silikonike (valplast)
- të përgatisë proteza të skeletuara
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë në laboratorin dentar

Ndjekja e shkollimit në profilin mësimor “**Teknik dentar**”, niveli II, do të zhvillojë te nxënësit edhe një tërësi kompetencash profesionale të cilat do t’i shërbejnë atij për vijimin e shkollimit dhe aftësimin profesional të mëtejshëm, si dhe për punësimin e suksesshëm në sektorin e kujdesit stomatologjik. Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

- të përgatisë kurorat e metal - porcelanit
- të përgatisë kurorat e zirkonit
- të përgatisë ura
- të punojë aparate mobile orodontike
- të punojë aparate fikse ortodontike
- të themelojë, të kryejë veprimtaritë e punës dhe të mbyllë veprimtarinë e një biznesi.
- të kryejë procedurat e aplikimit për punë.

2. Plani mësimor i profilit "Teknik dentar", klasat 10-11-12

Nr	LENDET DHE MODULET MESIMORE	Niveli I		
		Orë javore (Kredi)		
		KLASA 10	KLASA 11	KLASA 12
A	Lëndë të kulturës së përgjithshme	13 orë/javë (455 orë)	12 orë/javë (420 orë)	12 orë/javë (384 orë)
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	2 (7)	2 (7)	2 (6.4)
2	Gjuhë angleze	2 (7)	2 (7)	2 (6.4)
3	Gjuhë e huaj e dytë	1 (3.5)	1 (3.5)	1 (3.2)
4	Matematikë	2 (7)	2 (7)	2 (6.4)
5	Teknologji e informacionit	2 (7)	2 (7)	1 (3.2)
6	Ekonomi dhe ndërmarrësi	1 (3.5)	1 (3.5)	1 (3.2)
7	Edukatë fizike dhe shëndeti	2 (7)	2 (7)	2 (6.4)
11	Fizik	1 (3.5)	-	-
12	Biologji	-	1 (3.5)	1 (3.2)
B	Module profesionale	19 orë/javë (665)	20 orë/javë (700 orë)	20 orë/javë (640 orë)
1	Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut	4 (140)	-	-
2	Etika në shëndetësi	2 (70)	-	-
3	Parandalimi i infeksionit	2 (70)	-	-
4	Nevojat bazë të njeriut dhe dietat	2 (70)	-	-
5	Morfologjia e dhëmbit	6 (210)	-	-
6	Mjedisi i punës në laboratorin dentar	3 (105)	-	-
6	Teknologji e materialeve dentare	-	3 (105)	-
7	Protezat totale	-	5 (175)	-
8	Protezat parciale pllakore	-	4 (140)	-
9	Protezat skeletore	-	6 (210)	-
10	Mikrobiologji dhe imunologji	-	2 (70)	-
11	Punimi i kurorave	-	-	6 (192)
12	Aparatet ortodontike	-	-	5 (160)
13	Punimi i urave	-	-	6 (192)
	Module zgjedhore			
14	MZ(Ndihma e parë)			3 (96)
	MZ (Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies)			3
				3
	Shuma e orëve vjetore	32 orë/javë (665)	32 orë/javë (700 orë)	20 orë/javë (640 orë)

3. Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.

- Nw The British School of Kosova, përgatitja profesionale e nxënësve realizohet me anë të “moduleve profesionale”, të cilët janë me përmbajtje teorike - praktike. Në Planin mësimor të Kurrikulës bërthamë tregohet lista e moduleve profesionale të cilët janë të detyrueshëm të zbatohen dhe nuk mund të ndryshohen nga Qendrat e Kompetencës.
- Kurrikula bërthamë përmban “përshkruesit e moduleve profesionale”, të cilët duhet të zhvillohen dhe të detajohen më tej nga vetë mësimdhënësit e Qendrave të Kompetencës. Gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme, mësimdhënësit duhet të kenë parasysh që, për çdo modul profesional, *Rezultatet Mësimore dhe Kriteret e Vlerësimit* të nxënësve janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen prej tyre. Ndërsa përmbajtjet e rubrikave të tjera të moduleve profesionale janë rekomanduese dhe mund të përshtaten nga vetë mësimdhënësit në përputhje me zhvillimet më të fundit në profesionet përkatëse dhe kushtet konkrete për zbatimin e moduleve.
- Edhe nëse modulet profesionale do të trajtohen nga mësimdhënësit të veçantë, gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme dhe gjatë zbatimit të tyre duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë të të gjithë ekipit të mësimdhënësve që trajtojnë modulet profesionale të kualifikimit profesional përkatës.
- Për modulet profesionale, si njësi matëse e ngarkesës mësimore do të përdoret koncepti i *Kredisë*, ku një Kredi është i barazvlefshëm me 10 orë mësimore, ku një orë mësimore ka një kohëzgjatje prej 45 minutash.
- Përmbushja me sukses e moduleve profesionale kërkon integrimin e teorisë me praktikën e profesionit dhe për këtë, parimi i “*të nxënësve duke bërë*” duhet të zbatohet gjerësisht në procesin mësimor.
- Njohja e vazhdueshme e nxënësve me Rezultatet e të Mësuarit që përmbajnë përshkruesit e moduleve si dhe me Kriteret e Vlerësimit përkatëse, ndihmon në nxitjen e *motivimit* të nxënësve dhe lehtëson përvetësimin e kompetencave profesionale.
- Mësimdhënësit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimore të tilla që të fuqizojnë maksimalisht të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e atyre të kompetencave sociale e profesionale, të plota dhe të qëndrueshme.
- Rekomandohet që mësimdhënësit e moduleve profesionale të përdorin metoda mësimore që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe sjelljet dhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. Metoda e *punës në grup* duhet të jetë në themel të organizimit të mësimin teoritik dhe praktik për të zhvilluar te nxënësit *kompetencat profesionale*, të nevojshme për të përballuar me sukses vështirësitë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e ardhshme profesionale, me vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm, si dhe me veprimtarinë shoqërore si qytetar i një shoqërie demokratike.
- Një parim tjetër që duhet të zbatohet nga mësuesit e moduleve profesionale është që të nxënësve nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre. Dhënia e detyrave, puna hulumtuese dhe studimet e rastit të nxënësve kanë një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm.
- Rekomandohet që në trajtimin e Rezultateve Mësimore teorike të moduleve të përdoren metoda të tilla si *ligjërata, dhënia e shembujve, zgjidhja e problemit teoritik,*

- dhënia e detyrave* etj. Ndërsa në trajtimin e Rezultateve Mësimore praktike të përdoren kryesisht *demonstrimi nga mësimdhënësi, praktika e mbikëqyrur dhe praktika e pavarur e nxënësve.*
- Mësimdhënësit që trajtojnë modulet profesionale duhet të respektojnë *individualitetin* e nxënësve duke nxitur përparimin e shpejtë të nxënësve të përparuar dhe duke mbështetur nxënësit e prapambetur me veprimtari mësimore te veçanta.
 - Në kushtet e mungesës së mjediseve reale të punës për praktikimin e nxënësve, rekomandohet që në Qendrat e Kompetencës të krijohen *mjedise të simuluar* të punës.
 - The British School of Kosova duhet të krijojë *lidhje të ngushta me bizneset lokale* që kryejnë veprimtari në kualifikimet profesionale përkatëse, për të mundësuar praktikimin e nxënësve dhe marrjen e informatave për zhvillimet në profesionet përkatëse.
 - Përsa i përket *vlerësimit të nxënësve*, rekomandohet të përdoren metoda dhe instrumente vlerësimi që nxisin krijimin e kompetencave të nxënësve, shmangin subjektivizmin në vlerësim dhe tregojnë arritjet reale të tyre. Me rëndësi është vlerësimi i *vazhdueshëm* dhe ai *përfundimtar*, ku format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit përzgjidhen apo hartohen nga vetë mësimdhënësit. Duhet të synohet vlerësimi i arritjeve *i bazuar në kriteret* (ku arritjet e nxënësit krahasohen me standardet e paracaktuara) dhe të shmanget sa më shumë të jetë e mundur *vlerësimi i bazuar në renditjen* (ku nxënësit krahasohen me njëri-tjetrin). Metodat dhe instrumentet e vlerësimit që rekomandohen janë: pyetjet – përgjigjet me gojë, pyetjet - përgjigjet me shkrim, detyrat me shkrim, vëzhgimi i veprimtarisë së nxënësve, listat e kontrollit të veprimtarive praktike dhe të produkteve të punës, projekte për vlerësimin etj.
 - *Lista e kontrollit* duhet të jetë instrumenti bazë për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve, të testuara në situata pune reale apo të simuluar.
 - Mësimdhënësit duhet të përgatisin *Instrumentet e vlerësimit të nxënësve* për çdo Rezultat Mësimor të paraqitur në përshkruesit e moduleve profesionale, duke u bazuar në Kriteret e vlerësimit përkatëse.
 - Në rastin e nxënësve me *aftësi të kufizuara*, mësimdhënësit duhet të përshtasin programet e hollësishme të moduleve profesionale në përputhje me mundësitë fizike të këtyre nxënësve, si dhe të krijojnë kushte të përshtatëshme për zbatim.
 - Në përgjithësi, si për procesin mësimor, ashtu edhe për vlerësimin e nxënësve, duhet të synohen forma dhe metoda që e vendosin *nxënësin në qendër* të veprimtarive mësimore dhe e shndërrojnë rolin e mësimdhënësit nga një lektor i thjeshtë, në një organizator, mbikqyrës, nxitës dhe vlerësues i veprimtarisë së nxënësve.

4. Përshkruesit e moduleve profesionale

a) Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10-të.

PERSHKRUESI I MODULIT

“NDËRTIMI DHE FUNKSIONI I TRUPIT TË NJERIUT”

Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Teknik dentar

Vlera e Kredive të Modullit: 7 Kredi (140 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut”,
klasa 10:

- RM1: Nxënësi përshkruan karakteristikat morfologjike dhe funksionale të qelizës dhe indeve
RM2: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit kockorë dhe nyjorë
RM3: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskulator
RM4: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit kardiovaskular
RM5: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemeve të organeve
RM6: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit nervor

RM1: Nxënësi përshkruan karakteristikat morfologjike dhe funksionale të qelizës dhe indeve	
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë rëndësinë që ka njohja e ndërtimit dhe funksionimit të trupit të njeriut për punëtorin e lamisë së shëndetësisë.- të dallojë ndërtimin e qelizës- të shpjegojë funksionin e qelizës- të dallojë ndryshimin mes indeve- të dallojë karakteristikat e lëngjeve trupore- të përshkruaj funksionin e leukociteve, eritrociteve dhe trombociteve- të dallojë grupet e gjakut- të përshkruaj fazat e ndërprerjes së gjakderdhjes- të zbatojë rregullat e sjelljes dhe sigurisë në laborator/kabinat	
Kushtet e nevojshme: <ul style="list-style-type: none">- Klasë mësimore- Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe- Kabinat e anatomisë.- Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlase dhe modele.	
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- Ndërtimi dhe funksioni i qelizës	

<ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat morfologjike dhe funksionale të llojeve të ndryshme të indeve - Lëngjet trupore - Vetitë fizike, kimike, përbërja dhe roli i gjakut - Elementet e figuruar të gjakut (qelizat) - Grupet e gjakut - Ndërprerja e gjakderdhjes - Rregullat e sjelljes dhe sigurisë në laborator/kabinet
<p>Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ndryshimit mes qelizës dhe indeve - Dallimi i gjakut, si ind i lëngët, nga indet tjera kompakte - Identifikimi i qelizave të gjakut - Përcaktimi i grupeve të gjakut - Dallimi fazave të ndaljes së gjakderdhjes
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi korrekt gjatë punës në grup - Bashkëpunimi i ngushtë me mësimdhënësin - Mbajtja e rregullt e detyrave dhe shënimeve sipas modeli të dhënë.
<p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p>
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me shkrim (test) për aspektet teorike; - Listë – kontrolli për punët në laborator dhe për projektet.
<p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik. - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>.

<p>RM2: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit kockorë dhe nyjorë</p>
<p>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë ndërtimin e skeletit - të përshkruajë funksionin e skeletit në raport me aktivitetet e nevojshme - të emërtojë pjesët e skeletit. - të përshkruajë ndërtimin e skeletit të kokës - të përshkruajë ndërtimin e skeletit të trupit - të përshkruajë ndërtimin e skeletit të anësive - të përshkruajë ndërtimin e nyjes dhe funksionin lëvizës të saj - të përshkruajë ndërtimin e nyjës së bërrylit, krahut, dorës, gjurit, ijeve dhe boshtit të kurrizit
<p>Kushtet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë. - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, skelet, CD.
<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi dhe ndarja e skeletit - Skeleti i kokës, trupit dhe anësive

<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtim i nyjës lëvizëse dhe llojet e lëvizjeve - Nyja e bërrylit, krahut dhe dorës - Nyja e gjurit, ijëve dhe boshtit të kurrizit 	
Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ndërtimit të skeletit dhe nyejve. - Dallimi i funksionit të pjesëve të skeletit dhe nyejve 	
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup 	
Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:	
Metodat e Vlerësimit: <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me gojë - Pyetje –përgjigje me shkrim (test). 	
Evidentimi i Vlerësimit: <ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit me karakter teorik. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kritereve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>. 	

RM3: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskolor	
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruaj ndërtimin e muskujve - të përshkruaj funksionin fiziologjik të muskulaturës në raport me nevojat - të dallojë muskujt sipas funksionit - të përshkruaj forcën që zhvillojnë muskujt gjatë punës - të përshkruaj funksionin e muskujve të skeletit - të përshkruaj funksionin e muskujve të lëmuar - të dalloj muskulin e zemrës - të përshkruaj funksionin e muskulit të zemrës 	
Kushtet e nevojshme: <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë. - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD 	
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi histologjik i muskujve - Llojet e muskujve dhe karakteristikat e tyre funksionale - Puna dhe forca muskulore - Muskujt e lëmuar - Muskujt e kokës, qafës dhe anësive - Muskuli i zemrës 	
Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i muskujve të lëmuar - Dallimi i muskujve të skeletit - Dallimi i muskulit të zemrës 	
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi 	

<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup 	
Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:	
Metodat e Vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me gojë; - Pyetje –përgjigje me shkrim (test) 	
Evidentimi i Vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik. - Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës. - <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>. 	

RM4: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit kardiovaskular	
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruaj ndërtimin anatomik të zemrës - të përshkruaj ndërtimin anatomik të enëve të gjakut - të përshkruaj funksionin e qarkullimit të madh dhe të vogël të gjakut - të përshkruaj rolin e shtypjes së gjakut në funksionin normal të organeve - të dalloj pulsion arterial dhe kualitetet e tij 	
Kushtet e nevojshme:	
<ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore - Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe - Kabinet i anatomisë. - Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD 	
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Anatomia e zemrës dhe enëve të gjakut - Karakteristikat funksionale të muskulit të zemrës (rregullimi i punës së zemrës) - Karakteristikat morfologjike të enëve të gjakut - Qarkullimi sistematik (ligjet e hemodinamikës) - Shtypja e gjakut, pulsi arterial dhe kualitetet e tij 	
Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i veçorive të muskulit të zemrës - Dallimi i arterieve, venave dhe kapilarëve - Matja e shtypjes së gjakut - Matja e pulsit dhe dallimi i kualiteteve të tij 	
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi - Komunikimi korrekt - Bashkëpunimi gjatë punëve në grup 	
Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:	
Metodat e Vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Pyetje –përgjigje me gojë; - Pyetje – përgjigje me shkrim (test). 	
Evidentimi i Vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të 	

vlerësimin me karakter teorik.

- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimin me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës.
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimin në *Listën e kontrollit*.

RM5: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemeve të organeve

Kriteret e Vlerësimin të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruaj ndërtimin e rrugëve të frymëmarrjes
- të përshkruaj funksionin e rrugëve të sipërme dhe të poshtme të frymëmarrjes
- të përshkruaj funksionin e mushkërive
- të përshkruaj mekanikën e frymëmarrjes
- të përshkruaj ndërtimin e organeve të tretjes
- të përshkruaj funksionin e lukthit, zorrëve të holla dhe zorrës së trashë
- të përshkruaj metabolizmin e sheqernave, proteinave dhe yndyrave
- të përshkruaj rëndësinë e rregullimit të temperaturës
- të përshkruaj ndërtimin e veshkave
- të përshkruaj funksionin e veshkave dhe formimin e urinës
- të përshkruaj ndërtimin dhe funksionin e gjëndërrave endokrine
- të përshkruaj funksionin e hormoneve
- të përshkruaj ndërtimin e organeve gjinore (femërore dhe mashkullore)
- të përshkruaj funksionin reprodutiv të organeve gjinore

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore
- Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe
- Kabinet i anatomisë.
- Media didaktike si video projektor, flip chart, katalogë, atlas anatomik, CD.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:

- Ndërtimi dhe funksioni i rrugëve të frymëmarrjes
- Funksioni i mushkërive dhe pleurës
- Mekanika e frymëmarrjes dhe rregullimi neurohormonal
- Anatomia e organeve të tretjes
- Raportet topografike të organeve të tretjes
- Proceset sekretuese dhe tretëse të organeve të tretjes
- Metabolizmi i materieve ushqyese
- Temperatura dhe rregullimi i saj
- Anatomia dhe morfologjia e veshkës
- Funksioni i veshkës dhe formimi i urinës
- Karakteristikat morfologjike dhe funksionale të gjëndrave endokrine
- Veprimi fiziologjik i hormoneve
- Karakteristikat morfologjike të organeve gjinore femërore
- Karakteristikat e organeve gjinore mashkullore
- Fiziologjia e organeve gjinore

Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:

- Dallimi i ndërtimit të organeve të brendshme
- Dallimi i funksionit të organeve dhe sistemit të organeve

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:

- Prezantimi

- Komunikimi korrekt.
- Bashkëpunimi gjatë punës në grupe.

Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Pyetje –përgjigje me shkrim (test) .

Evidentimi i Vlerësimit:

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik.
- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës.
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në *Listën e kontrollit*.

RM6: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit nervorë

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruaj ndërtimin e sistemit nervorë
- të përshkruaj ndarjen e SNQ dhe SNP
- të përshkruaj ndërtimin dhe funksionet e palcës kurrizore
- të përshkruaj ndërtimin dhe funksionet e nervave periferik
- përshkruaj ndërtimin dhe funksionet e syrit, veshit, shqisës së nuhatjes, shijes dhe prekjës

Kushtet e nevojshme

- Klasë mësimore
- Laborator i pajisur me mikroskop dhe mullazhe
- Kabinet i anatomisë.
- Media didaktike si videoprojektor, flipchart, katalogë, atlas anatomik, skelet, CD.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:

- Ndërtimi dhe ndarja e sistemit nervorë
- Palca e kurrizit
- Truri
- Fiziologjia e sistemit nervorë qendrorë (SNQ)
- Fiziologjia e sistemit nervorë periferik
- Nervat trunoshpinorë
- Sistemi nervorë autonom dhe vegetativ
- Sistemi i organeve shqisore
- Fiziologjia e shqisave

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit:

- Dallimi i sistemit nervor qendror dhe periferik
- Dallimi i palcës së kurrizit
- Dallimi i nervave trunoshpinorë
- Dallimi i funksionit të syrit
- Dallimi i funksionit të veshit dhe ekuilibrit
- Dallimi i funksionit të gjuhës
- Dallimi i funksionit të shqisës së prekjës

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:

- Prezantim.
- Komunikimi korrekt.

- Bashkëpunimi i afërt gjatë punës në grupe
Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:
Metodat e Vlerësimit:
- Pyetje – përgjigje me gojë
- Pyetje –përgjigje me shkrim (test) për aspektet teorike;
Evidentimi i Vlerësimit:
- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik.
- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës.
- <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i> .

PERSHKRUESI I MODULIT

“ETIKA NË SHËNDETËSI”

Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Teknik dentar

Vlera e Kredive të Modullit: 3 Kredi (70 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP

Rezultatet Mësimore (RM) të Modulit “Etika në shëndetësi”, klasa 10:

RM1: Nxënësi zbaton rregullat bazë të etikës në shëndetësi

RM2: Nxënësi zgjidh me etikë problemet e përditshme në shëndetësi

RM1: Nxënësi zbaton rregullat bazë të etikës në shëndetësi

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e etikës shëndetësore
- të etikën e bashkëpunimit mes punëtorëve shëndetësorë;
- të përshkruajë parimin e hierarkisë në shëndetësi;
- të përshkruajë raste të mosmarrëveshjeve me kolegët dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre
- të përshkruajë mënyrat e sjelljes me pacientin gjatë pranimit, trajtimit dhe përcjelljes;
- të përshkruajë raste të mosmarrëveshjeve me pacientin dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre
- të përshkruajë mënyrat dhe format e sjelljes me komunitetin;
- të dallojë raste të ruajtjes së konfidencialitetit në shëndetësi;
- të përshkruajë mënyrat e informimit të familjarëve për raste të ndryshme
- të listojë llojet e dokumentacionit mjekësor
- të plotësojë dokumentacionit shëndetësor - regjistrat mjekësorë, librezat shëndetësore, kartela individuale
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së dokumentacionit mjekësor

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore
- Mjedise reale pune në sektorin e shëndetësisë.
- Media didaktike si modele të dokumenteve shëndetësore, videprojektor dhe CD.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi

- Kuptimi dhe rëndësia e etikës në shëndetësi
- Raporti mes punëtorëve shëndetësorë
- Raporti i punëtorit shëndetësor me pacientit
- Raporti punëtor shëndetësor – komuniteti/grupe të ndryshme sociale
- Rregullat e informimit të pacientit apo familjarëve
- Llojet e dokumentacionit mjekësor (regjistrat mjekësorë, librezat shëndetësore, kartela individuale, receta.)

Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Zbatimi i rregullave të etikës në shëndetësi.
- Plotësimi i dokumentacionit në shëndetësi.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi korrekt
- Bashkëpunimi.
- Ruajtja e dokumentacionit shëndetësor

Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje –përgjigje me gojë dhe me shkrim (test) për aspektet teorike;
- Listë – kontrolli për aspektet praktike.

Evidentimi i Vlerësimit:

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik.
- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen plotësimit dhe ruajtjes së dokumentacionit.
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur plotëson 45% të pikëve

ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në Listën e kontrollit.

RM2: Nxënësi zgjidh me etikë problemet e përditshme në shëndetësi

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rreziqet nga sëmundjet infektive si, hepatiti B, AIDS, sëmundje të lëkurës.
- të zbatojë masat mbrojtëse nga sëmundjet infektive si, hepatiti B, AIDS, sëmundje të lëkurës.
- të dallojë rreziqet nga materiale toksike, reagjentë të ndryshëm, medikamente helmuese
- të zbatojë masat mbrojtëse nga materiale toksike, reagjentë të ndryshëm, medikamente helmuese.
- të dallojë rastet e alergjive të mundshme në sektorin e shëndetësisë
- të dallojë raste të rrezikut nga narkomanët, persona historikë dhe skizofren.
- të zbatojë rregulla të thjeshta të etikës për planifikimin familjar
- të zbatojë rregulla të thjeshta të etikës për parandalimin e sëmundjeve infektive
- të zbatojë rregulla të thjeshta të etikës për persona me aftësi të kufizuara

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore
- Mjedise reale pune.
- Media didaktike si modele të dokumenteve shëndetësore, videoprojektor dhe CD.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:

- Mbrojtja nga sëmundjet infektive.
- Mbrojtja nga materialet toksike në shëndetësi.
- Rastet e alergjive në sektorin e shëndetësisë
- Mbrojtja nga personat e rrezikshëm (narkoman, historik, skizofren)
- Mbrojtja nga lëndimet në vendin e punës.
- Etika e komunikimit për edukim shëndetësor.

Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:

- Mbrojtja nga sëmundjet infektive, sëmundjet toksike, personat e rrezikshëm dhe rreziqet në vendin e punës.
- Zbaton rregullat e etikës për edukim shëndetësor.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:

- Komunikimi korrekt.
- Bashkëpunimi.

Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje –përgjigje gojë dhe me shkrim (test) për aspektet teorike;
- Listë – kontrolli për aspektet praktike.

Evidentimi i Vlerësimit:

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik.
- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen mbrojtjes nga sëmundjet infektive, sëmundjet toksike, personat e rrezikshëm dhe rreziqet në vendin e punës si dhe për zbatimin e rregullave të etikës për edukim shëndetësor.
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në testin me shkrim është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në Listën e kontrollit.

PERSHKRUESI I MODULIT
“PARANDALIMI I INFEKSIONIT”
Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Teknik dentar

Vlera e Kredive të Modullit: 3 Kredi (70 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Shkalla I e AP – Klasa 10

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “Parandalimi i infeksionit”, klasa 10:

RM1: Nxënësi zbaton higjienën personale

RM2: Nxënësi zbaton rregullat higjienike në vendin e punës

RM1: Nxënësi zbaton higjienën personale

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë konceptet themelore për higjienën
- të përshkruajë rëndësinë dhe ndikimin që ka mbajtja e higjienës personale.
- të përshkruajë rëndësinë dhe rolin e faktorëve të mjedisit në higjienë dhe ruajtjen e shëndetit.
- të përshkruajë rolin e veprimtarisë fizike në higjienën dhe shëndetin personal.
- të dallojë mënyrat dhe mjetet për mbajtjen së higjienës së trupit në jetën e përditshme
- të dallojë mënyrat dhe mjetet për mbajtjen së higjienës së gojës dhe dhëmbëve në jetën e përditshme
- të përshkruajë aspektet shëndetësore dhe estetike të mbajtjes së higjienës së gojës dhe dhëmbëve.
- të dallojë mënyrat dhe mjetet për mbajtjen së higjienës së veshmbathjes në jetën e përditshme

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore
- Mjedise reale pune në sektorin e shëndetësisë.
- Media didaktike si modele të dokumenteve shëndetësore, videprojektor, CD dhe materiale nga interneti.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Koncepte themelore për higjienën
- Rëndësia dhe roli i mbajtjes së higjienës personale
- Rëndësia dhe roli i faktorëve të mjedisit dhe veprimtaria fizike në ruajtjen e shëndetit.
- Higjiena e trupit
- Higjiena e gojës dhe dhëmbëve.
- Higjiena e veshmbathjes.

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Mbajtja e higjienës së trupit, gojës dhe veshmbathjes në jetën e përditshme.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi korrekt.
- Bashkëpunimi.
- Diskutimi dhe prezantimi i çështjeve që trajtohen në RM.

Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje –përgjigje me gojë dhe shkrim (test) për aspektet teorike;
- Listë – kontrolli për aspektet praktike.

Evidentimi i Vlerësimit:

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik.
- Vlerësim i çdo nxënësi me Listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen demonstrimit të mbajtjes së higjienës së trupit, gojës dhe veshmbathjes në jetën e përditshme dhe në punë në sektorin e shëndetësisë.
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në

RM2: Nxënësi zbaton rregullat e higjienës në shëndetësi

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rregullat bazë të higjienës në sektorin e shëndetësisë.
- të përshkruajë rregullat bazë për higjienizimin e mjeteve
- të përshkruajë rregullat bazë për higjienizimin e veglave
- të zbatojë rregullat bazë për higjienizimin e mjeteve dhe veglave të punës
- të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e sterilizimit.
- të evidentojë rastet e kryerjes së sterilizimit në shëndetësi
- të evidentojë metodat dhe mjetet e kryerjes së sterilizimit.
- të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e dezinfektimit
- të evidentojë rastet e kryerjes së dezinfektimit.
- të dallojë llojet e dezinfektantëve dhe mjetet dezinfektuese.
- të dezinfektojë mjedisin e punës.
- të kryejë dezinfektimin e duarve dhe veshmbathjes
- të përshkruajë masat mbrojtëse gjatë sterilizimit dhe dezinfektimit.

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore
- Mjedise reale pune në sektorin e shëndetësisë ku kryhen higjienizime, sterilizime dhe dezinfektime.
